



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR

Nr. 520 Prot.

Tiranë, më 06.12.2023

**URDHËR**

Nr. 41, datë 06/12/2023

**PËR**

**MIRATIMIN E KODIT ETIK SË INSPEKTORATIT QENDROR**

Në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 14.09.2011, "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.08.2013, "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-Inspektimi";

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Kodit të Etikës së Inspektoratit Qendror, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë integrale e tij.
2. Ngarkohen nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të Inspektoratit Qendror për zbatimin e rregullave të përcaktuara në Kodin e Etikës.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror [www.insq.gov.al](http://www.insq.gov.al).

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**SHKELQIM HAJDARI**





# **KODI I ETIKËS INSPEKTORATI QENDROR**

## **Përmbajtja**

### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1	Qëllimi
Neni 2	Fusha e zbatimit
Neni 3	Parimet bazë
Neni 4	Parimi i ligjshmërisë
Neni 5	Parimi i mosdiskriminimit
Neni 6	Parimi i përgjegjshmërisë
Neni 7	Parimi i objektivitetit dhe paanësisë
Neni 8	Parimi i konfidencialitetit

### **KREU II**

#### **RREGULLAT E SJELLJES**

Neni 9	Etika për nëpunësit e Inspektoratit Qendror
Neni 10	Sjellja etike
Neni 11	Raporti epror – vartës
Neni 12	Marrëdhëniet ndërmjet kolegëve
Neni 13	Rregulla të bashkëpunimit
Neni 14	Komunikimi
Neni 15	Kodi i veshjes
Neni 16	Pijet alkoolike dhe pirja e duhanit

### **KREU III**

#### **MARRËDHËNIET ME VEPRIMTARI JASHTË OBJEKTIT TË PUNËS**

Neni 17	Konflikti i interesave
Neni 18	Dhuratat, favoret apo përfitime të tjera
Neni 19	Sanksionet

# **RREGULLA ETIKE INSPEKTORATI QENDROR**

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Qëllimi**

Kodi i Etikës ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe standardeve të sjelljes dhe etikës profesionale, që duhet të respektohen nga nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të Inspektoratit Qendror.

### **Neni 2 Fusha e zbatimit**

Kodi i Etikës së Inspektoratit Qendror është i zbatueshëm për të gjithë nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të Inspektoratit Qendror, ekspertë që mund të angazhohen nga Inspektorati Qendror sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, si dhe për praktikantët.

Në kuptim të këtij Kodi, në vijim termi “nëpunës” nënkupton nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të Inspektoratit Qendror.

### **Neni 3 Parimet bazë**

Nëpunësit e Inspektoratit Qendror e ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe detyrat funksionale në përputhje me këto parime:

- a. Parimin e ligjshmërisë;
- b. Parimin e mosdiskriminimit;
- c. Parimin e përgjegjshmërisë;
- d. Parimin e objektivitetit dhe paanësisë;
- e. Parimin e konfidencialitetit.

### **Neni 4 Parimi i ligjshmërisë**

Në ushtrimin e veprimtarisë së tyre dhe detyrave funksionale, nëpunësit e Inspektoratit Qendror zbatojnë Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjisllacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 5

### **Parimi i mosdiskriminimit**

Në trajtimin e kërkesave dhe ankesave, si dhe në marrjen e vendimeve, nëpunësit e Inspektoratit Qendror sigurojnë respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Nëpunësi duhet të shmangë çdo situatë diskriminuese midis subjekteve kërkuese apo ankuese bazuar në kombësi, gjini, racë, etni, veçori gjenetike, gjuhë, fenë apo besimin, mendimin politik apo tjetër, anëtarësimin në një minoritet kombëtar, pronësinë, lindjen, paaftësinë fizike, moshën apo orientimin seksual.

Nëpunësi duhet të kujdeset të shmangë çdo situatë diskriminuese sipas përcaktimeve në këtë nen brenda dhe jashtë ambiente të punës, me qëllim garantimin e sjelljes etike, me integritet dhe profesionalizëm.

## Neni 6

### **Parimi i përgjegjshmërisë**

Nëpunësit e Inspektoratit Qendror në kryerjen dhe përmbushjen e detyrave funksionale janë transparentë, të besueshëm, profesionalë dhe mbajnë përgjegjësi për çdo veprim apo mosveprim që bie në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 7

### **Parimi i objektivitetit dhe paanësisë**

Nëpunësit e Inspektoratit Qendror duhet të veprojnë me ndershmëri, objektivitet dhe paanësi në përmbushjen e detyrave të tyre funksionale.

Nëpunësit gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara duhet të mbështeten në ligj, të veprojnë me profesionalizëm, pa u ndikuar nga interesat personale, familjare apo presioni politik.

## Neni 8

### **Parimi i konfidencialitetit**

Nëpunësit e Inspektoratit Qendror ruajnë konfidencialitetin e informacionit, por pa çenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, si dhe mbrojnë të dhënat personale në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Informacionet dhe të dhënat konfidenciale nuk duhet të lihen në vendin e punës të pambrojtura, si dhe duhet të merren të gjitha masat e nevojshme që të respektohen detyrimet që përcaktohen në ligj.

## KREU II RREGULLAT E SJELLJES

### Neni 9

#### **Etika për nëpunësit e Inspektoratit Qendror**

Nëpunësit e Inspektoratit Qendror duhet të ruajnë reputacionin, dinjitetin, si dhe të qëndrojnë larg çdo veprimi, qëndrimi apo sjellje e cila mund të zhvlerësojë emrin e mirë të punonjësit dhe institucionit që përfaqëson.

Nëpunësi i Inspektoratit Qendror është i detyruar t'u përmbahet normave të etikës si gjatë orarit të punës ashtu edhe jashtë orarit të punës.

Nëpunësi i Inspektoratit Qendror duhet të ruajë konfidencialitetin që buron nga ligji, në lidhje me informacionin dhe materialin që njihet dhe merr dijeni gjatë kryerjes së detyrës. Ky konfidencialitet nuk është i kufizuar në kohë.

Nëpunësi duhet të jetë i sjellshëm në marrëdhënie dhe në komunikimin shkresor e verbal me epororët, kolegët dhe vartësit e tij si dhe të respektojë parimet e etikës sipas legjislacionit në fuqi.

Në komunikimin e përditshëm brenda institucionit, nëpunësit duhet të respektojnë shkallën hierarkike. Gjatë komunikimit, çdo nëpunës duhet të karakterizohet nga etika dhe respekti i ndërsjellë.

Komunikimi verbal në ambientet e Inspektoratit Qendror nuk duhet të bëhet me zë të lartë.

### Neni 10

#### **Sjellja etike**

Nëpunësi i Inspektoratit Qendror duhet:

- a. të respektojë standardet e sjelljes etike, si brenda ashtu edhe jashtë ambienteve të institucionit;
- b. të përkrahë frymën që përçojnë parimet, ligjet, aktet nënligjore dhe udhëzimet që zbatohen në institucion;
- c. të nxisë përgjegjshmërinë ndaj vetes, kolegëve dhe publikut;
- d. të duhet të shmangë çdo situatë që përbën mungesë respekti ndaj të tjerëve, padrejtësi dhe pa ndershmëri;
- e. të mos qëndrojë indiferent kur përballet me situata apo probleme që lidhen me sjelljen etike;
- f. duhet të jetë modest dhe të marrë vendime të ndërgjegjshme.

## Neni 11

### Raporti epror-vartës

Eprori ka të drejtë të kërkojë dhe kontrollojë përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive nga vartësi. Vartësi duhet të respektojë urdhrat dhe porositë e eprorit dhe ta informojë atë në kohë për përmbushjen e tyre.

Në rastet e veprimtarive të bashkërenduara, caktohet personi përgjegjës dhe përcaktohen qartë detyrat për secilin nëpunës.

Si rregull, gjatë ushtrimit të detyrës nuk lejohet qortimi i vartësve në publik. Çdo drejtues dhe epror duhet të bazohet në parimet e humanizmit, rolit këshillues dhe bashkëpunimit.

## Neni 12

### Marrëdhëniet ndërmjet kolegëve

Në marrëdhëniet dhe në komunikimin me njëri-tjetrin gjatë kohës së punës, nëpunësit e Inspektoratit Qendror duhet të përdorin gjuhën zyrtare dhe të respektojnë njëri-tjetrin, në përputhje me rregullat e etikës.

## Neni 13

### Rregulla të bashkëpunimit

Marrëdhëniet mes punonjësve të Inspektoratit Qendror bazohen në shkallën e hierarkisë dhe të funksionit. Nëpunësit e Inspektoratit Qendror brenda fushës së përgjegjësive kategorizohen në eprorë, vartës dhe kolegë.

Bazat e marrëdhënieve të punës në Inspektoratin Qendror janë detyrimi për të kryer detyrën funksionale, respekti, mbështetja dhe ndihma reciproke, ndërtimi i marrëdhënieve të sinqerta e të mirëkuptimit dhe respektimi i besimit të të tjerëve.

## Neni 14

### Komunikimi

Gjatë komunikimit, nëpunësit e Inspektoratit Qendror duhet të respektojnë shkallën e hierarkisë, të tregojnë sjellje të mirë, etikë morale e profesionale dhe respekt të ndërsjellë.

Komunikimi i brendshëm është komunikimi i titullarit me drejtorinë, sektorët dhe nëpunësit në varësi të tij, me qëllim dhënien e detyrave, marrjen e informacioneve, njohjen dhe prezantimin me aktet normative, rekrutimet, trajnimet, aplikimet, njohjen me ndryshimet në organikën e Inspektoratit Qendror, me përgjithësime, masa disiplinore, stimuj të ndryshëm, etj.

Komunikimi i jashtëm është komunikimi i Inspektoratit Qendror me struktura të tjera të inspektorateve shtetërore/vendore/trupa të tjera inspektuese, administratës publike, me median, shoqërinë civile, grupet e interesit dhe publikun. Inspektorati Qendror informon publikun nëpërmjet takimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin, nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, fletëpalosjeve mbi inspektimin dhe shkeljen e kërkesave ligjore nga subjektet e inspektimit, si dhe nëpërmjet faqes zyrtare [www.insq.gov.al](http://www.insq.gov.al).

#### Neni 15

#### **Kodi i veshjes**

Paraqitja e nëpunësve në punë duhet të jetë e tillë që të shprehë nivelin e autoritetit të institucionit që përfaqëson, si dhe të vetë punonjësit.

Veshja dhe paraqitja e punonjësve duhet të jetë formale dhe serioze, për t'u përfaqësuar sa më denjësisht gjatë ushtrimit të detyrës.

Gjatë orarit zyrtar është e papranueshme mbajtja e veshjeve të papërshtatshme, që përfshijnë: kostumet sportive, pantallonat e shkurtra, minifundet, xhinset, veshjet me slogane, transparente dhe/ose provokative.

#### Neni 16

#### **Pijet alkoolike dhe pirja e duhanit**

Gjatë kohëzgjatjes së punës, nëpunësit i ndalohet të konsumojë pije alkoolike, si brenda ashtu edhe jashtë ambienteve të institucionit.

Ndalohet pirja e duhanit në mjediset e punës. Këto mjedise janë të pajisura me shenjën dalluese që identifikon këtë ndalesë. Pirja e duhanit mund të lejohet vetëm në ambientet e caktuara për këtë qëllim jashtë ambienteve të institucionit.

### KREU III

### **MARRËDHËNIET ME VEPRIMTARI JASHTË OBJEKTIT TË PUNËS**

#### Neni 17

#### **Konflikti i interesave**

Nëpunësit kur i ngarkohet një detyrë, e cila e vendos në kushtet e konfliktit të interesave, duhet të deklarojë sa më parë të jetë e mundur, konfliktin ose konfliktet e mundshme të interesave, të cilat mund të ndikojnë negativisht në ushtrimin e paanshëm të detyrave prej tij.



Nëpunësi i Inspektoratit Qendror duhet të respektojë dhe zbatojë detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar dhe Rregulloren e Inspektoratit Qendror "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Inspektoratin Qendror"<sup>1</sup>.

#### Neni 18

#### **Dhuratat, favoret apo përfitime të tjera**

Ndalohet kërkimi ose marrja nga nëpunësi i dhuratave, favoreve, çfarëdo përfitimi tjetër, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilët ka marrëdhënie, që ndikojnë, duket sikur ndikojnë ose mund të ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrave funksionale.

Në çdo rast, nëse persona të caktuar tentojnë të ndikojnë në kryerjen e detyrës nga ana e nëpunësit në kushtet e konfliktit të interesave, ai duhet të njoftojë menjëherë eprorin e tij të drejtpërdrejtë.

Nëpunësit të Inspektoratit Qendror i ndalohet të bëjë premtime private në emër të institucionit.

Nëpunësi i Inspektoratit Qendror nuk duhet të përdorë ose të lejojë të përdorin persona të tjerë të lidhur me të, detyrën e tij zyrtare, në mënyrë të tillë që të nxisë ose të detyrojë një person tjetër, përfshirë edhe vartësit, për të pasur përfitim financiar ose çdo lloj tjetër me interes personal.

#### Neni 19

#### **Sanksionet**

Për shkelje të dispozitave të përcaktuara në këtë Kod, kur veprimet nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen në rrugë administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

<sup>1</sup> Miratuar me Urdhrin nr. 7, datë 20.03.2012, të Inspektorit të Përgjithshëm